



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Nr. i prot.188

Datë:04.08.2015, Prishtinë

Në bazë të Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ për Procedurën e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë Nr. 17/2009:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PËR KËTË VEND TË LIRË TË PUNËS:

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Kodi i pozitës	Vend i lirë/ Zëvendësim
SHFMU	Elena Gjika	Prishtinë	Një mësimdhënës për edukatë fizike, (14 orë në “Elena Gjika” dhe 6 orë në “Sami Frashëri” në gjuhën turke)	01	Vendi i lirë

I. Aplikacioni duhet të ketë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri**. Diploma ose certifikata duhet të përcaktoj qartë notën mesatare.

Shenim: Çdo diplomë ose certificate para ose pas diplomimit që nuk përcakton qart notën mesatare nuk do të merret në shqyrtim.

II. Dëshmi shtesë për fazës paraseleksionuese :

- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT, gjegjësisht **vetëm ato që konsiderohen relevante për nivelin e arsimit përkatës nga ana e DKA**

- Dëshmi të përvojës së punës vetëm në institucione arsimore (**vetëm kontrata ose vërtetimi i nga ana e punëdhënësit që përcakton qartë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës do të merren parasysh**).

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DKA në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse (UA Nr. 17/2009 dhe **UA Nr. 06/2015**). **Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim.**

IV. Kushtet e veqanta:

Kandidati duhet njohuri shumë të mira në gjuhën turke (Në të shkruar dhe në të folur).

Sqarime shtesë:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

V. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Me rastin e marrjes së aplikacionit, kandidatët mund të marrin edhe dokumentin ku përshkruhet procedura e përzgjedhjes dhe dokumentin ku përshkruhen kriteret e paraseleksionimit.

Për intervistë do të ftohet 3-5 kandidatët që i plotësojnë më së miri kushtet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Përzgjedhja për intervistë do të bëhet bazuar në kualifikimet formale adekuate, përvojën e punës relevante në arsim, trajnimet e përfunduara relevante të akredituara nga MASHT dhe notën mesatare gjatë studimeve.

Shenim: master i papërfunduar duhet të sillen certifikata e notave (origjinale).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **04.08.2015** gjer më datën **12.08.2015**.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.